



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 mars 2013
Nr. ref.:RK400/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI103/12

Parashtrues

“INTEGRAL”, Sh.p.k.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme të Kosovës, ASC-11-0056-A0001, të 7 qershorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Kompania “Integral”, një kompani private nga Prishtina, të cilën e përfaqëson Agim Aliu, drejtor.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme), me nr. ASC-11-0056-A0001, i nxjerrë më 7 qershor 2012, e që i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 5 korrik 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me aktgjykimin e kontestuar të Dhomës së Posaçme, i janë cenuar të drejtat e pronës, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të anulojë aktgjykimin e kontestuar dhe ta kthejë çështjen për rishqyrtim në Dhomën e Posaçme.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet: 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 19 tetor 2012, parashtruesi paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 31 tetor 2012, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi Gjyqtare raportuese si dhe, me Vendimin KSH.103/12, e datës së njëjtë, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
8. Më 13 mars 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 7 shtator 2006, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), me të cilën kërkoi vërtetimin e pronësisë mbi patundshmërinë, një lokal afarist që gjendet në Prishtinë, rruga "UÇK", nr. 2 (ish-rruga "APJ", më vonë rruga "Kral Millutini"), me sipërfaqe të përgjithshme 814.00 m². Parashtruesi i kërkesës e kishte bazuar padinë në kontratën e shitblerjes, të lidhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Investbank, Sh.a. (në procedurë të falimentimit) në Beograd. Kontrata e shitblerjes ishte vërtetuar në Gjykatën e Parë Komunale në Beograd, me nr. 900/61, më 19 prill 2006.
10. Më 15 mars 2007, AKM-ja dërgoi përgjigje në padinë e parashtruesit, duke theksuar, *inter alia*, se prona e kontestuar i përket Bankës së Kosovës, e njohur si Bankkos, Banka Themelore në Prishtinë, e cila është pjesë e Bankës së Kosovës Sh.a. (në tekstin e mëtejme: Banka). AKM-ja, po ashtu, deklaroi se kishte kryer hetime dhe

kishte vërtetuar se Banka ishte themeluar nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh.) dhe se asetet e saj ishin pronë shoqërore.

11. Më 13 prill 2011, Trupi gjykues nxori aktgjykimin SCC-06-0394, me të cilin refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit.
12. Trupi gjykues, në arsyetim, theksoi si në vijim: *“Pasi që Gjykata konstatoi se paditësi (pra parashtruesi i kërkesës) nuk posedon prova për titullin juridik, kontesti pronësor mbetet në mes të Investbank-ës dhe Bankkos-it (siç administrohet ose jo nga AKM-ja), për çka nuk ka përcaktime në këtë dosje. Kjo është arsyeja pse titulli i paraqitur nga paditësi nuk mund të përbëjë një arsye të vlefshme për padinë.”*
13. Më 23 maj 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të fakteve dhe të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale.
14. Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin e kontestuar, nr. ASC-11-0056-10001, më 7 qershor 2012, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, të 13 prillit 2011, SCC-06-0394.
15. Në arsyetimin ligjor, Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme, theksoi: *“Trupi gjykues i DHPGJS-së ka theksuar mjaft qartë në arsyetim ...se paditësi nuk posedon asnjë provë për titullin juridik”.*
16. Kolegji i ankesave vërtetoi mendimin e Trupit gjykues se *“transferimi i të drejtës së paditësit për pronësinë nëpërmjet ‘titullit të pronësisë’, që ai e kishte poseduar, nuk është kryer në mënyrë ligjore”.* Kolegji i ankesave, po ashtu, konfirmoi se asetet e kontestuara *“janë pronë shoqërore”.*
17. Përveç kësaj, Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme, theksoi: *“Transferimi i të drejtës së pronësisë për pasuritë e kontestuara është bërë në bazë të një kontrate të lidhur në Beograd, e cila nuk i ka përmbushur kërkesat ligjore të ligjit të zbatueshëm në Kosovë. Prandaj, kjo kontratë nuk paraqet veprim të ligjshëm të ligjit të zbatueshëm në Kosovë, dhe e njëjta nuk përbën provë të titullit juridik që do të lejonte paditësin të bëjë transferimin dhe regjistrimin pa pengesë të së drejtës së pronës për pasuritë e blera”.*
18. Për më tepër, Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme vërejti se, pasi pasuritë e blera nga parashtruesi i kërkesës gjenden në Prishtinë, ndërsa kontrata e shitblerjes është vërtetuar në gjykatë në Beograd, si i tillë, ky veprim juridik nuk prodhon efekt juridik.
19. Përfundimisht, Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme gjeti se *“ky veprim ligjor ishte në kundërshtim edhe me nenin 4 të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme ...një dispozitë që ndalon tjetërsimin e pasurive të paluajtshme në pronësi shoqërore tek personat privatë”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë cenuar të drejtat e njeriut, të garantuara me Kushtetutë, pasi Dhoma e Posaçme

“pa të drejtë pretendon se paditësi nuk posedon asnjë dëshmi lidhur me titullin ligjor për të vërtetuar të drejtën e vet pronësore në lokalitetin afarist”. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “banka, si institucion financiar, nuk mund të trajtohet si ndërmarrje shoqërore apo publike”. Parashtruesi i kërkesës vëren se “Investbanka Sh.p.k., në pajtim me ligjin ka zbatuar procedurën e falimentimit, vendimin për shitjen e pasurisë jo vetëm në Kosovë por edhe në vende tjera të ish-Jugosllavisë...”. Parashtruesi i kërkesës konsideron se kontrata e shitblerjes ishte lidhur dhe ishte vërtetuar në gjykatën kompetente në Beograd, në pajtim me ligjin e aplikueshëm.

21. Rrjedhimisht, parashtruesi kërkon që *“çdo pretendim, qoftë nga gjykata apo nga ndonjë institucion tjetër, për t’ia mohuar Integral sh.p.k. të drejtat pronësore lidhur me lokalitetin e blerë, duke e kontestuar titullin ligjor për bartjen e të drejtës së pronësisë, është e kundërligjshme dhe është shkelje e dispozitave kushtetuese, më konkretisht e nenit 22 dhe atij 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Në mënyrë që të mund të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata, së pari, duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
24. Gjykata, më tej, vëren se parashtruesi e ka parashtruar kërkesën brenda afatit kohor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
25. Gjykata, po ashtu, duhet të shqyrtojë nëse kërkesa e parashtruesit i plotëson kriteret e tjera të pranueshmërisë, të përcaktuara me rregullin 36.2 të Rregullores së punës, ku thuhet:

“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

- a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*
- b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
- c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose*
- d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

26. Gjykata Kushtetuese rikujton se ajo nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).
27. Gjykata Kushtetuese vëren, nga faktet e paraqitura në kërkesë, se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që në faza të ndryshme të procedurës të parashtrtojë argumentet për të cilat ka konsideruar se janë relevante për rastin. Arsyetimi faktik dhe ligjor për vendimin e shkallës së parë, me të cilin u refuzua padia e parashtruesit, është shtjelluar gjerësisht. Në aktgjykimin gjatë fazës ankimore, Kolegji i ankesave e

pranoi deklaratën e fakteve dhe arsyetimin ligjor të dhënë në aktgjykimin e Trupit gjykues, në kuptimin që ato nuk ishin në kundërshtim me të gjeturat e tij. Rrjedhimisht, edhe Trupi gjykues e edhe Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme morën parasysh dhe me të vërtetë iu përgjigjën ankesave të parashtruesit përkitazi me çështjet e ligjit.

28. Gjykata rithekson se ka kompetencë të kufizuar për të trajtuar gabimet e pretenduara në fakte, apo në ligj, të bëra nga gjykatat e rregullta, dhe se nuk mund të zëvendësojë këndvështrimin e gjykatave të rregullta përkitazi me pronësinë e parashtruesit mbi lokalitetin afarist me këndvështrimin e vet (*Shih, Jantner kundër Sllovakisë, nr. 39050/97, paragrafi 32, Aktgjykimi i 4 marsit 2003 i GJEDNJ-së*).
29. Rrjedhimisht, edhe nëse supozojmë se aktgjykimet e Dhomës së Posaçme kanë ndërhyrë në të drejtën e parashtruesit në pronë, ato ishin të bazuara në ligj dhe në proporcion me interesin publik për mbrojtjen e të drejtave të pronarëve të vërtetë (*Shih, mutatis mutandis, Čadek dhe të tjerët kundër Republikës Çeke, paragrafi 51, aktgjykimi i 21 nëntorit 2012 i GJEDNJ-së*). Prandaj, këto ankesa janë qartazi të pabazuara.
30. Prandaj, Gjykata, në pajtim me rregullin 36.2 (c) të Rregullores së punës, hedh poshtë kërkesën si qartazi të pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe në mbështetje të rregullit 36.2 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani